



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KONSULTATIV I BIZNESIT

VENDIM

Nr. 1, date 28.12.2006

Per

**Miratimin e Rregullores per Funkcionimin e Keshillit Konsultativ te Biznesit dhe
te Buxhetit te vitit 2007 te ketij Keshilli**

Ne mbeshtetje te nenit 3 dhe 5 te Ligjit Nr.9607, date 11.09. 2006, "Per Keshillin Konsultativ te Biznesit", ne mbledhjen e dates 28.12.2006, Keshilli Konsultativ i Biznesit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores per Funkcionimin e Keshillit Konsultativ te Biznesit sipas tekstit qe i bashkelidhet ketij vendimi;
2. Miratimin e buxhetit te Keshillit Konsultativ te Biznesit per vitin 2007 sipas tabelës qe i bashkelidhet ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI

GENC RULI

Minister i Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes

Miruar me Vendimin Nr.1, date 28.12.2006 te mbledhjes se KK te Biznesit

Kryetari i Keshillit Konsultativ te Biznesit

GENC RULI

Minister i Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes

**Rregullore
Per Funksonimin e Keshillit Konsultativ te Biznesit**

KAPITULLI I I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

**Neni 1
Baza ligjore e Rregullores**

Rregullorja “Per Funksonimin e Keshillit Konsultativ te Biznesit” eshte dokumenti baze qe rregullon veprimtarine e ketij Keshilli, krijimi i te cilit mbeshtetet nga ligji Nr.9607, date 11.09. 2006, “Per Keshillin Konsultativ te Biznesit”.

**Neni 2
Statusi Juridik i Keshillit Konsultativ te Biznesit**

Keshilli Konsultativ i Biznesit eshte organ keshillimor i qeverise, per zhvillimin e politikave ekonomike dhe per permiresimin e kuadrit ligjor perkates.

**Neni 3
Emertimi i shkurtuar dhe Vula**

Emertimi i shkurtuar i Keshillit Konsultativ te Biznesit eshte KKB.

Selia e KKB ndodhet ne Ministrine e Ekonomise dhe Energjetikes, ne adresen Bulevardi “Deshmoret e Kombit” Nr.2, Tirane.

Permbajtja e Vules se KKB eshte : Republika e Shqiperise, Keshilli Konsultativ i Biznesit (KKB).

KAPITULLI II

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE KKB

Neni 4 Objekti

KKB ka objekt te veprimtarisë se tij:

- Forcimin e dialogut publik-privat per politikat e zhvillimit te biznesit dhe investimeve;
- Përgatitjen e rekomandimeve për qeverinë dhe kuvendin ne lidhje me:
 - o procesin e hartimit te strategjive dhe programeve qeveritare te zhvillimit te ekonomisë;
 - o procesin e përgatitjes se buxhetit te shtetit dhe paketave fiskale;
 - o politikat e privatizimit;
 - o politikat e prokurimit publik;
 - o politikat e nxitjes se investimeve;
 - o politikat e zhvillimit te tregtisë dhe biznesit;
 - o politikat e konkurrencës, mbikëqyrjes se tregut dhe mbrojtjes se konsumatorit.
- Identifikimin dhe vendosjen e prioriteteve ne ceshtjet qe kufizojnë veprimtarinë e biznesit dhe te investimeve;

BURIMET E FINANCIMIT

Neni 5 Burimet e financimit

Burimet e Financimit te KKB janë :

- Kuotizacioni i anëtareve te tij, perfaqesues te organizatave te biznesit;
- Sektorit privat;
- Donatore te ndryshëm;
- Buxheti i shtetit,

Neni 6 Perdorimi i fondeve

Financimi qe KKB merr nga burimet e ndryshme, përdoret vetëm për kryerjen e veprimtarive sipas objektit te tij, sipas kuadrit ligjor ne fuqi.

Donoret e huaj ose vendas te cilët kontribuojnë me fonde financiare, kane te drejte te informohen nga KKB, mbi përdorimin e këtyre fondeve.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KKB

Neni 7 Organet e KKB

Organet e KKB janë:

- Kryetari i KK te Biznesit
- Sekretariati teknik

Perberja e Keshillit Konsultativ i Biznesit

Neni 8 Përbërja

Ne perputhje me ligjin, anetaret konstitues ne mbledhjen e pare te keshillit jane:

1. Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes- Ministri - Kryetar
2. Bashkimi i DHTI
3. Dhoma Amerikane e Tregtise
4. Dhoma e Tregtise dhe Industrise –Tirane
5. Shoqata Konfindustria
6. Konfederata e Artizanatit Shqiptar
7. Keshilli i Agrobiznesit
8. Dhoma e Tregtise Shqiperi-Britani e Madhe
9. Shoqata e Investitoreve te Huaj
10. Shoqata e Ndertuesve
11. Shoqata e Bankave
12. Shoqata e Bashkive
13. Qendra Nderkombetare e Tregtise/ACIT
14. Drejtori i Politikave te Nxitjes se Biznesit ne Ministrine e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes
15. Ministria e Financave – Zevendesministri
16. Drejtori i Politikave Fiskale ne Ministrine e Financave
17. Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
18. Agjencia e Biznesit dhe Investimeve/ Albinvest

Neni 9 Procedurat dhe kriteret e emërimit te anëtareve te KKB

Organizatrat qe perfaqesojne sektorin privat apo shoqërinë civile ne KKB, propozojnë tre kandidatura, nga te cilat, zgjidhet një kandidat. Anëtaaret duhet te plotësojnë këto kushte:

- Kandidati nuk duhet te kete qene i denuar me vendim gjykate apo te jete ne proces gjyqesor ose ndjekje penale;

- Kandidati duhet te jete person fizik qe ka eksperience te gjate pune ne fushën e menaxhimit te biznesit, ose akademik, ekspert ne fushën e ekonomisë, bankave dhe jurisprudencës, qe ushtron aktivitetin ne territorin e Republikës se Shqipërisë, ne sektorët e prodhimit, shërbimit, turizmit, banka, arsim, studio ligjore, te vërtetuar nga institucioni ku ai punon;
- Kandidati duhet te gezoje reputacion dhe te kontribuojë ne zhvillimin e dialogut me qeverine
- **Për anëtarët qe perfaqesojne sektorin publik :**
- Kandidati për anëtar ne KKB, duhet te jete ne nivel Zv/Ministri, drejtori te përgjithshëm ose drejtor drejtorie;
- Kandidati për sektorin qe përfaqëson, duhet te zotërojë kuadrin legjislativ, programet dhe strategjitë e qeverise qe ndikojnë ne klimën e biznesit;

Anëtarët e KKB emërohen nga ministri përgjegjës për ekonominë, për nje periudhe 2 vjeçare, me te drejte rizgjedhje.

Neni 10

Mandati i anëtarit te Këshillit Konsultativ te Biznesit

Mandati i anëtarit te KKB, përfundon me:

- a) kerkesen e subjektit te cilin ai perfaqeson;
- b) mbarimin e afatit te përcaktuar nenin 6 te ligjit per KK te Biznesit, si dhe ne rastet kur,
- c) jep dorëheqjen,
- ç) shkarkohet nga detyra, nga Kryetari i KKB, për veprime ose mosveprime qe dëmtojnë rende interesat e KKB;
- d) mungon pa arsye ne 4 mbledhje te një viti.

Kërkesa për dorëheqje i behet me shkrim Kryetarit te KKB, i cili e miraton atë brenda 10 (dhjete) ditëve.

Neni 11

Kompetencat e KKB

Këshilli Konsultativ i Biznesit ka këto kompetenca:

- Përgatit rekomandime për qeverinë dhe kuvendin;
- Miraton rregulloren për funksionimin e KKB dhe ndryshimet përkatëse ne rastet kur e dikton nevoja;
- Miraton krijimin e grupeve këshillimore ad-hoc;
- Miraton programin vjetor te veprimtarisë se KKB, i cili paraqitet nga Sekretariati Teknik;
- Miraton guidën vjetore te biznesit;
- Miraton planin vjetor te punës;

- Miraton raportin vjetor te KKB;

Neni 12

Kompetencat e Kryetarit te KKB

Kryetari i Këshillit Konsultativ te Biznesit ka këto kompetenca :

- Emëron anëtarët e KKB, mbi bazën e kandidaturave te propozuara nga organizatat e biznesit dhe institucionet publike;
- Drejton veprimtarinë e KKB;
- Emëron sekretariatit teknik sipas propozimeve te anëtareve te KKB-se;
- Dërgon rekomandimet përkatëse, te pergjithshme dhe specifike ne adrese te qeverise dhe parlamentit për çdo mbledhje te realizuar;
- Bashkëpunon me donatore vendas dhe te huaj për sigurimin e fondeve te KKB;
- Krijon, zhvillon dhe ruan lidhje te vazhdueshme institucionale me perfaqesues te organizatave te biznesit dhe institucioneve publike;
- Siguron cilësinë e materialeve informuese te bëra nga KKB dhe shpërndarjen ne kohe te tyre, institucioneve publike e private te interesuara;
- Përfaqëson institucionin ne marrëdhënie me te tretet.

Neni 13

Funksionet e Sekretariatit Teknik

Sekretariati teknik kryen këto funksione:

- siguron mbarëvajtjen e veprimtarisë se KKB;
- përgatit dosjet për çdo anëtar te KKB sipas rendit te ditës;
- siguron shërbimin e përkthimit ne rastet kur shoqatat e biznesit përfaqësohen me kandidate jo shqipfolës;
- mban procesverbalet si dhe përgatit konkluzionet dhe rekomandimet e dala nga çdo mbledhje e KKB;
- siguron shkëmbim informacioni me institucionet publike dhe private, duke përfshire edhe marrëdhëniet me median;
- përgatit raportet dhe informacionet e nevojshme dhe i ve ato ne dispozicion te anëtareve te KKB;
- informon me shkrim anëtarët e KKB, për ndikimin e rekomandimeve te këshillit, për statusin e legjislacionit te diskutuar ne KKB dhe qe është ne procesin e diskutimeve parlamentare;
- identifikon nevojat për pune kërkimore (anketime, vlerësime, studime)
- drejton dhe monitoron punën e komisioneve te këshillimit;
- përgatit guidën vjetore te biznesit;
- përgatit planin vjetor te punës;
- përgatit raportin vjetor te KKB;

Neni 14

Perberja dhe detyrat e Stafit te Sekretariatit Teknik

Sekretariati teknik përbehet nga 2 anëtar me kohe te plote dhe ka këtë përbërje:

- sekretari teknik
- administratori

Detyrat e sekretarit teknik:

- drejton dhe koordinon punën e sekretariatit;
- përgatit raportet dhe informacionet e nevojshme për Kryetarin dhe anëtarët e KKB;
- identifikon nevojat për pune kërkimore;
- drejton dhe monitoron punën e komisioneve të këshillimit;
- zhvillon termat e referencës dhe kontraktin grupet e punës për nevoja të KKB;

Detyrat e administratorit:

- Përgatit mbledhjet e KKB;
- Mban procesverbalet e të gjitha mbledhjeve të KKB;
- Mban dokumentacionin shkresor dhe tere korrespondencën zyrtare të KKB;
- Administron fondet financiare të KKB sipas ligjeve në fuqi.

Neni 15

Krijimi dhe funksionet e Komisioneve të Këshillimit

Komisionet e këshillimit krijohen mbi baza “*ad-hoc*”, me vendim të KKB. Ato kanë në përbërje të tyre përfaqësues nga shoqatat e biznesit, agjencitë publike, konsulentë teknikë dhe grupe të tjera të interesit.

Komisionet drejtohen nga përfaqësuesi i sektorit privat që është anëtar i KKB.

Komisioni i këshillimit ka këto përgjegjësi:

- Mundëson pjesëmarrje sa më të gjërë të palëve të interesuara në përbërje të grupeve të punës;
- siguron informacion nga anëtarësia e shoqatave të biznesit, grupet e interesit dhe nga institucionet publike;
- organizon forume publike kur e gjykon të nevojshme, për të kërkuar mendime për çështjet që trajton;
- përgatit dhe paraqet për miratim në KKB, studimet, raportet dhe konkluzionet e punës për të cilin është krijuar.

Neni 16

Publikimet e KKB

Publikimet e KKB janë:

Guida Vjetore e Biznesit

- Guida e biznesit, përfaqëson një informacion përmbledhës të vlerësimeve që i bëhet kuadrit ligjor ekzistues në vendin tone, nga donatorët, organizata dhe institucione

financiare ndërkombëtare, duke e krahasuar me vendet e rajonit nëpërmjet disa treguesve.

- Guida gjithashtu përfshin ndryshimet që ka pësuar kuadrit ligjor dhe institucional gjatë periudhës një vjeçare.
- Guida i shërben përgatitjes së planit vjetor të KKB.

Plani vjetor i punës

Plani vjetor i punës, përfshin fushat prioritare që do të jenë objekt diskutimi në KKB, si dhe komisionet që do të formohen.

Fushat prioritare përcaktohen në baze të sondazheve të bëra me anëtarët e KKB si dhe duke tërhequr mendimet e institucioneve publike.

Raporti vjetor i KKB-se

Raporti vjetor përmban:

- Misionin dhe objektivat vjetore të KKB;
- Përbërjen e anëtareve për atë vit;
- Çështjet dhe temat e shqyrtuara nga KKB;
- Komisionet e këshillimit, përbërja dhe rekomandimet e tyre;
- Rekomandimet e adresuara në qeveri dhe komisionet parlamentare;
- Ndikimi i këtyre rekomandimeve në ndryshimin e legjislacionit
- Analizën financiare vjetore

Neni 17

Mbledhja e Këshillit Konsultativ të Biznesit

Kryetari i Këshillit Konsultativ të Biznesit thërret mbledhjen e KKB-se mënyrë periodike, jo më pak se 4 herë në vit.

Anëtarët lajmërohen me shkrim nga Sekretariati teknik, 15 ditë para zhvillimit të mbledhjes. Në njoftimin e mbledhjes jepen data, ora, vendi i zhvillimit të mbledhjes si dhe rendi i ditës. Përveç njoftimit, bashkëlidhen dokumentacioni i nevojshëm që do të shqyrtohet sipas rendit të ditës.

Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Këshillit dhe në mungesë të tij, nga Zëvendësministri që mbulon ekonominë.

Neni 18

Pjesëmarrja në mbledhje të anëtareve të KKB dhe personave të tjerë

Në mbledhjet e KKB është e domosdoshme pjesëmarrja e anëtareve të zgjedhur dhe nuk lejohet delegimi.

Kryetari i KKB fton këshilltarë ose/dhe eksperte të jashtëm, kur këto e kërkojnë rrethanat.

Sekretariati teknik, këshilltaret dhe ekspertet e jashtëm të ftuar kontribuojnë me diskutimet e tyre në mbledhjet e KKB.

Neni 19 **Vlefshmëria e rregullores**

Rregullorja hyn në fuqi pas diskutimit dhe miratimit në mbledhjen e parë të KKB. Vendimi për miratim merret me 50 përqind plus një të anetareve pjesëmarrës në mbledhje. Kjo rregullore firmoset nga kryetari i KKB.

Rregullorja i behet e njohur të gjithë organizatave të biznesit, institucioneve të administratës publike, Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Tirane, më 28.12. 2006